


D.T.I.M.P  
23.12.2021



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
KORÇE**

Korçë, me 17.12.2021

**SHPLLJE VENDIMI**

Drejtuar : Bashkise Maliq

Per: Z. Nikollaq Kreka  
Me adrese: Blloku nr. 3 Maliq

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil nr. 928 dt. 15.11.2021 per t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor*, pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin : " Largar " dhe pas afishimit kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule e firme, ne gjykate.

**KANCELARE  
Lubiana KINOLLI**



U afishua ne Bashkine Maliq  
sot me date

Nenpunesi \_\_\_\_\_

(emer, mbiemer, firme)

Mr. 130 Post



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
KORÇË

Nr.regj.21001-01277-41-2021 (1205)  
Datë regj.01.09.2021

Nr.vendimi 41-2021-3695(928)  
Datë vendimi 15.11.2021

VENDIM  
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me trup gjykues të përbërë prej:  
Gjyqtarit të vetëm **Seladin PYSQYLI**, asistuar nga sekretare Brilda Hoxhallari, në Gjykatë, sot më datë 15.11.2021, përfundoi gjykimin e çështjes civile me palë dhe objekt:

**PADITËSE:** Mirela Kreka (Mbiemri paramartesor Skënderaj), e bija e Jemin dhe Xhevo, e datëlindjes 30.03.1978, lindur në Patos, Fier, dhe banuese në Rr. “Rudower Strabe”, nr.87, 20G, Berlin, Treptow, Gjermani, përfaqësuar nga avokat Rizvaldo Vrenozi antar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me prokurë të posaçme nr. Regj.266561106 datë 13.07.2021, të hartuar në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Berlin, Gjermani, në mungesë.

**I PADITUR:** Nikollaq Kreka, i biri Aleko dhe Kristina, i datëlindjes 29.09.1974, lindur në Korçë dhe banues në Maliq, Blloki nr.1, në mungesë.

**OBJEKTI:** Zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur midis palëve më datë 17.09.1999.

**Baza ligjore:** Neni 132 e vijues i K.Familjes.

Gjykata, pasi verifikoi në lidhje me prezencën e palëve dhe rezultoi të mos jetë paraqitur asnjëra prej tyre,

VËREN SE:

Me padinë drejtuar gjykatës, paditësja ka kërkuar zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur më datë 17.09.1999, midis paditëses Mirela Kreka dhe të paditurit Nikollaq Kreka.

Pasi çështja i'u nënshtrua shortit elektronik, bazuar në nenin 134 të K.Familjes, gjykata caktoi seancën për pajtim në datën 15.11.2021, ora 10:00, dhe urdhëroi njoftimin e palëve. Në këtë seancë nuk u paraqit asnjëri nga bashkëshortët. Për paditësen, m.q.s. jeton në Gjermani, njoftimi u realizua nëpërmjet avokatit Rizvaldo Vrenozi i zgjedhur me prokurë. M.q.s. avokati nuk u paraqit as vetë në këtë seancë, pas çeljes së seancës u kontaktua me të nëpërmjet telefonit dhe ai deklaroi se: Paditësja ka dijeni për datën dhe orën e gjykimit por nuk mund të paraqitet për shkak se është shtatzanë dhe mjekët i kanë sugjeruar të shmangë lëvizjet me avion dhe nisur nga ky fakt, u shpreh që gjykata të pushojë gjykimin, dhe padinë do ta ngrerë në një moment tjetër. Në lidhje me të paditurin Nikollaq Kreka, njoftimi u kthye me shënimin “Larguar”.

Gjykata, pasi verifikoi prezencën e palëve dhe aktet në lidhje me njoftimin e tyre, referuar nenit 299/ç të K.Pr.Civile, çmon se duhet të vendoset pushimi i gjykimit, pasi kjo dispozitë parashikon: “Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ç) Pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj”. Në rastin konkret jemi para një padie me objekt zgjidhje martese dhe pushimi i gjykimit për shkak të mosparaqitjes së paditësit parashikohet në nenin 135/1 të K.Familjes, i cili përcakton se: “Në rast se në seancën e pajtimit nuk paraqitet paditësi, ndonëse ka pasur dijeni rregullisht, gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit të

çështjes". Në lidhje me shkaqet e arsyeshme neni 175 i K.Pr.Civile parasëkon se: "Pasi deklarohet çelja e seancës gjyqësore, gjykata verifikon paraqitjen e palëve dhe heton shkaqet kur njëra ose të dyja nuk janë paraqitur në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkak sëmundjeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm, gjykata shtyn gjykimin për një ditë tjetër". Gjykata hetoi në lidhje me shkaqet e mosparaqitjes dhe rezultoi që paditësja nuk kishte bërë prezent asnjë lloj shkakut të arsyeshëm.

Përsa i takon shpenzimeve gjyqësore, paditësja ka parapaguar tarifën mbi aktet në shumën 3.000 lek dhe shpenzimet për njoftimet, të cilat bazuar në nenin 106 e vijues të K.Pr.Civile, duhet të lihen në ngarkim të tij.

Nisur nga fakti që midis palëve nuk ka detyrime reciproke, gjykata çmon se nuk jemi para rasteve për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit sipas parashikimit të neneve 510 e 511 të K.Pr.Civile i ndryshuar.

### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 135/1 të K.Familjes dhe nenin 299/ç të K.Pr.Civile,  
VENDOSI:

-Pushimin e gjykimit të çështjes civile me nr. regj. 21001-01277-41-2021 (1205), datë regjistrimi 01.09.2021, me paditëse Mirela Kreka, i paditur Nikollaq Kreka, me objekt zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur midis tyre më datë 17.09.1999.

-Shpenzimet gjyqësore që përbëhen nga tarifa mbi aktet në shumën 3.000 (tre mijë) lek dhe shpenzimet e tjera gjyqësore, lihen në ngarkim të paditëses.

-Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejten e ankimit të veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar nga e nesërmyja e njoftimit të vendimit të arsyeshëm.

-U shpall në Korçë, sot më datë 15.11.2021.

SEKRETARE  
Brilda HOXHALLARI

SEKRETAR

E POROSITUR

GJYQATAR

Jeladin PYSOYLI

